



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1188/6 prot.

Datë 30.04.2026

V E N D I M
Nr. 576/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Tërnova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh për Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik të Impiantit Boville për vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

Ankimues: “ISOMETRIC” SHPK, me NIPT (L92207009A), me adresë: PESHKOPI, Dibër.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k me NIPT L41629009A, dhe adresë: Rruga Pavaresia Ndertesa Nr. 1, Kati i Trete, Zyra 340 dhe magazine, Mezez..

Autoriteti Kontraktor: SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane me adresë: Rruga Llazi Miho, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05-01-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje

reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.2. Në datën 23-01-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05-03-2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me vlerë 6.490.000 lekë skualifikuar (Në përgjigje të këtij njoftimi, me shkresën nr. 3610 prot., datë 26.02.2026, operatori ekonomik “Carpathia Albania sh.p.k.” dorëzoi pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e sipërcituar. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e realizimit të kontratës për kontratën e ngjashme, dokument i kërkuar në kuadër të përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Ky dokument përbën një element thelbësor për të provuar përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik në realizimin e kontratave të ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi. Mungesa e këtij dokumenti nuk mundëson verifikimin e plotë të përmbushjes së kriterit për përvojë të mëparshme dhe, për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk arrin të provojë përmbushjen e këtij kriteri të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik “Carpathia Albania sh.p.k.” nuk përmbush kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, për rrjedhojë, skualifikohet nga procedura e prokurimit. Në vijim të procedurës dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vijojë me verifikimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik të renditur në vendin pasardhës në klasifikimin e ofertave.)

2. OE “ISOMETRIC” SHPK	me vlerë 6.643.985	lekë kualifikuar
3. OE “ALBUJI” SHPK	me vlerë 7.280.000	lekë kualifikuar
4. OE “GAMMA” SHPK	me vlerë 7.300.000	lekë kualifikuar
5. OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK	me vlerë 7.346.566,50	lekë kualifikuar
6. OE “KRIJON” SHPK	me vlerë 7.346.566,50	lekë kualifikuar
7. OE “KEJ Group” SHPK	me vlerë 7.351.355	lekë kualifikuar
8.OE “Skyline SC” SHPK	me vlerë 8.331.086	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 13.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 17.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 859/2026 protokoli, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.859/1 prot, datë 18.03.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet postës, ka përcjellë shkresën nr. 19468/13 prot., datë 25.03.2026, protokolluar me tonën me nr.859/2 prot., datë 27.03.2026, ku verehet se ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “CARPATHIA ALBANIA” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar e cila është dërguar edhe nëpërmjet postës elektronike Autoritetit kontraktor, rezulton, se ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “CARPATHIA ALBANIA” SHPK.

II.8. Në date 27.03.2026 Komisioni i Prokurimit publik ka marrë vendimin nr. 437/2026, ku ka vendosur si më poshtë:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokuirmit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Carpathia Albania” Shpk, në buxhetin e shtetit.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

II.9. Në date 08.04.2026 Komisioni i Prokurimit publik ka marrë vendimin nr. 485/2026, ku ka vendosur si më poshtë:

1. *“Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. “

II.10. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6553, datë 17.04.2026 dhe me nr. protokoll 1188/2026 datë 20.04.2026 e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1188/1 prot, datë 21.04.2026.

II.12. Me shkresën nr. 19468/21 prot, datë 24.04.2026, protokolluar me tonën me nr.1188/2 prot., datë 27.04.2026 ardhur nëpërmjet shërbimit postar autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ISOMETRIC” SHPK, ku konstatohet se ka vendosur të mos e pranojë ankesën.

II.13. Në datë 27.04.2026 nëpërmjet SPE, është paraqitur formular i argumenteve i protokolluar me tonën datë 1188/3 datë 27.04.2026, sipas parashikimeve të nenit 113 të “Ligjit për prokurimin publik” i ndryshuar nga OE “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k. në cilësinë e palës së interesuar, që ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohet nga ankesa e paraqitur, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ISOMETRIC” SHPK lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 05-01-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh për Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik të Impiantit Boville për vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01-2026, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

III.1.2. II.2. Në datën 23-01-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05-03-2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me vlerë 6.490.000 lekë skualifikuar (Në përgjigje të këtij njoftimi, me shkresën nr. 3610 prot., datë 26.02.2026, operatori ekonomik “Carpathia Albania sh.p.k.” dorëzoi pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e sipërcituar. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e realizimit të kontratës për kontratën e ngjashme, dokument i kërkuar në kuadër të përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Ky dokument përbën një element thelbësor për të provuar përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik në realizimin e kontratave të ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi. Mungesa e këtij dokumenti nuk mundëson verifikimin e plotë të përmbushjes së kriterit për përvojë të mëparshme dhe, për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk arrin të provojë përmbushjen e këtij kriteri të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik “Carpathia Albania sh.p.k.” nuk përmbush kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, për rrjedhojë, skualifikohet nga

procedura e prokurimit. Në vijim të procedurës dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vijojë me verifikimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik të renditur në vendin pasardhës në klasifikimin e ofertave.)

2. OE “ISOMETRIC” SHPK	me vlerë 6.643.985	lekë kualifikuar
3. OE “ALBUJI” SHPK	me vlerë 7.280.000	lekë kualifikuar
4. OE “GAMMA” SHPK	me vlerë 7.300.000	lekë kualifikuar
5. OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK	me vlerë 7.346.566,50	lekë kualifikuar
6. OE “KRIJON” SHPK	me vlerë 7.346.566,50	lekë kualifikuar
7. OE “KEJ Group” SHPK	me vlerë 7.351.355	lekë kualifikuar
8.OE “Skyline SC” SHPK	me vlerë 8.331.086	lekë skualifikuar

III.1.4. Në datën 13.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.1.5. II.5. Në datën 17.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 859/2026 protokoli, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.859/1 prot, datë 18.03.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.7. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6553, datë 17.04.2026 dhe me nr. protokoli 1188/2026 datë 20.04.2026 e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të

paraqitura nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.8. Neni 111, pika 1, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“1.Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”*

III.1.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”

III.1.10. Neni 112, pikat 1,2 dhe 3 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.*

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”

III.1.11. Neni 113, i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.*

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”

III.1.12. Në nenin 114, pikat 1,4,5 dhe 6, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.1.13. Neni 115, pika 1,2 dhe 3 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; b) në*

rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji; b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.14. Në nenin 118, pika 2, germa “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.*

III.1.15. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk është respektuar afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe nga sa me sipërcituar operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën dhe që mund të cënohen nga vendimmarrja e autoriteti kontraktor, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 5 të nenit 114. Në rastin konkret, rezulton, se operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK ka qenë në dijeni që prej datës 13.03.2026, ku është bërë publikimi i njoftimit të fituesit paraprak prej nga ku konstatohej arsyeja e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” shpk, dhe prej nga ku operatori ekonomik ankimues mund të paraqiste ankesën me pretendimet për lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve për skualifikim të operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” shpk, duke vijuar më tej me faktin se duke qenë gjithashtu në dijeni që operatori

ekonomik i skualifikuar “CARPATHIA ALBANIA” shpk ka paraqitur ankesë për shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimit e ofertës së paraqitur prej tij, prej nga ku operatorit ekonomik ankimues mund të paraqiste argumentat pasi mund të çenohej në vazhdimësi të shqyrtimit të ankesës së OE “CARPATHIA ALBANIA” shpk. Ndërkohë ankesa e operatorit ekonomik ankimues “ISOMETRIC” SHPK **është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 17.04.2026 me numër elektronik të ankesës nr. A/2026/6553, dhe me nr. 1188/2026 datë 20.04.2026**, jashtë afateve ligjore të ankimimit, edhe pse publikimi i njoftimit të fituesit paraprak për vendimin e marrë nga autoriteti kontraktor që vinte në dijeni arsyen e skualifikimit dhe gjendjen e operatorit ekonomik OE “CARPATHIA ALBANIA” shpk është bërë në datë 13.03.2026, si dhe publikimi i formulari për ankesën me numër 859/2026 protokoli, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k për procedurën e prokurimit të sipërcituar, është bërë në datë 18.03.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k, dhe prej asaj date nuk rezulton as ankesë dhe as argumente nga operatori ekonomik ankimues “ISOMETRIC” SHPK.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, për vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” shpk të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 114 pika 5 e LPP, i cili parashikon se: *“Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni”*.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 17.04.2026, për pretendimet për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “CARPATHIA ALBANIA” shpk, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit sipas parashikimeve të LPP, ndaj përbën shkak për mospranimin e këtij pretendim të ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një

rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkarkuar nga COVID-19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryej veprimet përkatëse për kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

